



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
FAKULTETI I VEPRIMTARISË FIZIKE DHE REKREACIONIT
DEKANI

Nr. 911/2 Prot.

Tiranë, më 29. 04. 2026

NJOFTIM

**PËR HAPJEN E THIRJES PËR PRANIM NË PROGRAMIN E STUDIMIT TË
CIKLIT TË TRETË DOKTORATË NË “AKTIVITETI FIZIK DHE SHËNDETI” PËR
VITIN AKADEMIK 2025 - 2026**

Mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; Vendimin e Këshillit të Ministrave, Nr. 112, datë 23.02.2018 "Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore "Doktor" dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademik "Profesor i Asociuar" dhe "Profesor", i ndryshuar; Rregulloren e Studimeve të Doktoratës në Universitetin e Sporteve të Tiranës; në shkresën Nr. 59/7 Prot., datë 07.04.2026 të Ministrisë së Arsimit; si dhe në Urdhrin e Rektorit të UST Nr. 11, datë 24.04.2026, "Për hapjen e thirrjes për pranimet në programet e ciklit të tretë Doktoratë në "Shkenca Sportive" dhe "Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti", për vitin akademik 2025-2026 në Universitetin e Sporteve të Tiranës, Dekani i FVFR vendosi të shpallë njoftimin për hapjen e thirrjes për pranim në programin e ciklit të tretë të studimit "Doktoratë" në "Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti" për vitin akademik 2025 – 2026.

Programi i studimit: Cikli i tretë "Doktoratë"

Fusha kryesore e kërkimit: "Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti"

Nënfusha: "Impakti shëndetësor, social-kulturor dhe ekonomik i aktivitetit fizik të aplikuar në fitnes, rekreacion dhe turizëm"

KUOTAT PËR VITIN AKADEMIK 2025 – 2026

Kuotat për vitin akademik 2025 – 2026 dhe udhëheqësit shkencor të miratuar nga Ministria e Arsimit janë si më poshtë:

Nr.	Tituli	Emri, Mbiemri	Nr. i udhëheqjeve 2025-2026
1	Profesor	Ferdinand Mara	1
2	Profesor	Robert Çitozi	1
3	Prof. Asc. Dr.	Entela Kushta	1
4	Prof. Asc. Dr.	Elona Mehmeti	1

KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT TË KANDIDATËVE NË STUDIMET E CIKLIT TË TRETË “DOKTORATË”

1. Diplomë universitare “Master i shkencave” në fushën / nënfushën përkatëse të programit të studimit;
2. Diplomë e sistemit të vjetër 4 – vjeçar në fushën / nënfushën përkatëse të programit të studimit;
3. Master i Shkencave ose DND të fituara në institucione të tjera të arsimit të lartë, brenda ose jashtë vendit, në përputhje me përcaktimet e bëra në programin e studimeve të doktoratës ose në Rregulloren e saj;
4. Diplomat e fituara jashtë vendit duhet të ekuivalentohen përpara aplikimit, sipas akteve ligjore në fuqi të ministrisë përgjegjëse për arsimin;
5. Të ketë angazhim si personel akademik në një institucion të arsimit të lartë apo si personel kërkimor në një institucion të kërkimit bazë ose të zbatuar, pranë institucioneve të arsimit të lartë të llojit “Universitet” ose “Akademi”, të cilat plotësojnë kriteret ligjore në fuqi;
6. Njohje të njëjës prej pesë gjuhëve të huaja si: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht, të vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkombëtare në nivelin e miratuar nga Senati Akademik i UST, në përputhje me kornizën ligjore në fuqi;
7. Nëse kandidati ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga pesë gjuhët e përmendura më sipër, diploma e fituar i shërben si dëshmi për plotësimin e kriterit të gjuhës së huaj.

Shënim: Vetëm kandidatët të cilët plotësojnë të gjitha kriteret e mësipërme kualifikohen për fazën tjetër të vlerësimit.

KRITERE SPECIFIKE DHE PREFERENCIALE TË PRANIMIT TË KANDIDATËVE NË STUDIMET E CIKLIT TË TRETË “DOKTORATË”

Kriteri specifik si më poshtë vijon:

1. Nota mesatare mbi 8 e diplomave universitare (DNP + DND) do të vlerësohen me 0.5 pikë për çdo 0.1 notë.

Kriteret preferenciale janë si më poshtë vijon:

1. Kandidatët të cilët janë personel akademik me kohë të plotë në UST.
2. Kandidatët të cilët kanë marrë pjesë me punime shkencore në konferenca / kongrese / simpoziume shkencore si dhe të ketë botime në fushën e programit të studimit ku aplikon.
3. Kandidatët të cilët kanë përfunduar programe kualifikime të tjera të ciklit të tretë, si Master Ekzekutiv / Specializime afatgjata apo ekuivalent me to, në drejtime që lidhen me fushën e kërkimit.

**DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR APLIKIM NË PROGRAMIN E
STUDIMIT TË CIKLIT TË TRETË DOKTORATË NË
“AKTIVITETI FIZIK DHE SHËNDETI”**

1. *Curriculum Vitae* personale dhe bibliografi të punimeve shkencore, të cilat duhet të jenë të dokumentuara, nëse aplikanti ka të tilla;
2. Kopje të noterizuar të diplomave të kërkuara sipas pikës 1,a. të nenit 6, të shoqëruar me listën e notave apo suplementin e diplomës. Diplomat e huaja shoqërohen me vërtetimin e njohjes nga Ministria përgjegjëse për arsimin;
3. Kopje të noterizuar të diplomave të cikleve të studimeve apo të një diplome ose certificate të barasvlefshme me to, shoqëruar me listën e notave apo suplementin e diplomës, nëse kandidati zotëron një të tillë;
4. Fotokopje e kartës së identitetit/pasaportës;
5. 2 (dy) fotografi;
6. 2 (dy) rekomandime nga personel me titull akademik;
7. Një deklaratë që pranon të shlyejë të gjitha detyrimet financiare lidhur me koston e këtyre studimeve, në rastet e vetëfinancimit;
8. Dëshmi të gjuhës/gjuhëve të huaja (fotokopje të noterizuar) sipas akteve ligjore në fuqi;
9. Vërtetim nga qendra e punës, nëse është i punësuar, që dëshmon se aplikanti është personel akademik ose personel i përfshirë në kërkim shkencor;
10. Projekt Ideja Kërkimore e hartuar nga kandidati aplikant sipas Shtojcës 4;
11. Mandat pagesa për tarifën e aplikimit;
12. Vetëdeklarim të aplikantit se do të zbatojë standardet shkencore dhe etike;
13. Vetëdeklarim të aplikantit se nuk ka patur në të kaluarën shkelje të rregullave të etikës së kërkimit shkencor, të të drejtave që burojnë nga pronësia intelektuale apo shkelje të rregullave kundër plagjiaturës.

Shënim: Dosja duhet të ketë inventar dorëzimi, i cili firmoset në momentin e dorëzimit nga kandidati aplikant dhe personeli i protokollit.

AFATET PËR PARAQITJEN E APLIKIMEVE

Aplikimet e kandidatëve për studimet e ciklit të tretë "Doktoratë" në Universitetin e Sporteve të Tiranës, do të kryhen nga data **04.05.2026 – 04.06.2026**.

Shënim: Dosja e aplikimit, drejtuar njësisë kryesore / njësisë bazë përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, dorëzohet pranë zyrës së protokollit të UST.

D E K A N I


Prof. Asc. Dr. Elton SPAHIU

